



01.Nr. 104/02-6278/22

Kaçanik, 04.03.2022

Në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 5 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

MBI THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLORES TË PUNËS NË PALESTRËN SPORTIVE

1. Me këtë vendim themelohet komisioni për hartimin e Rregullores të Punës në Palestrën Sportive, me anëtarët si në vijim:
 1. Fatos Vishi- kryesues;
 2. Fatmir Qaka- anëtar;
 3. Ilir Lumi- anëtar;
 4. Nasur Shehu- anëtar;
 5. Valdrin Dogani- anëtar;
 6. Kaltrina Luma- anëtare dhe
 7. Lulzim Krasniqi- anëtar.
2. Detyrat e komisionit si në pikën 1 të këtij vendimi janë hartimi, krijimi i draftit fillestar dhe përfillja e të gjitha hapave ligjore sipas Rregullores (MAPL) Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës për hartimin e Rregullores të Punës në Palestrën Sportive.
3. Obligohet komisioni që të bashkërendon procesin e hartimit të këtij akti me të gjitha njësitë brenda komunës, të cilat janë të obliguara të ofrojnë ndihmë sipas kërkesave të tij si dhe sipas nevojës bashkërendon punën me zyrën ligjore dhe njësit tjera përkatëse për Integritet Evropian dhe atë të financave.
4. Mandati i komisionit si në pikën 1. të këtij vendimi, përfundon me rastin e miratimit të Rregullores dhe publikimin e saj në Gazetën Zyrtare.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve;

Arkivit.

Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 610/01-5664/2022
Kaçanik, 04.03.2022

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut Kryetari i Komunës lëshon këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim u ndahen mirënjohje falenderuese për kontributin e dhënë në arsim nëntëmbëdhjetë (19) mësimdhënësve nga Komuna e Kaçanikut, mësimdhënës të pensionuar gjatë vitit 2021-2022.
2. Mirënjohje u ndahen edhe katërmëdhjetë (14) mësimdhënësve më të dalluar nga institucionet shkollore në Komunën e Kaçanikut si në vijim:

- 1.1. Gjimnazi "Skenderbeu"
- 1.2. SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezrit Çaka"
- 1.3. SHFMU "Emin Duraku"
- 1.4. SHFMU "Qamil Ilazi"
- 1.5. SHFMU "Ali Asllani"
- 1.6. SHFMU " 7 Shtatori"
- 1.7. SHFMU "Dituria"
- 1.8. SHFMU "Naim Frashëri"
- 1.9. SHFMU "Agim Bajrami"
- 2.10 SHFMU "Kadri Zeka"
- 2.10. SHFMU "Jusuf Gërvalla"
- 2.11 SHFMU "Idriz Seferi"
- 2.12 SHFMU " Nazmi Osmani"
- 2.13. SHFMU " Gafurr Luma"

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim të njoftohet
-Drejtoria për Arsim

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi





10.03.2022

01.Nr. 104/02-6751/22

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40- për Vetëqeverisjen Lokale, neni 2 dhe 9 të Rregullores së MF. Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore si dhe me qëllim të përfundimit të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Auditimit (theksimi i qështjes- pasuria nën 1000 euro) për vitin 2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ASGJËSIMIN DHE TJETËRSIMIN E PASURISË JO FINANCIARE

- Me këtë Vendim, emërohet komisioni për asgjësimin dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare në përbërje prej:
 - Zekir Selimi - kryesues,
 - Kaltrina Luma - anëtare,
 - Sadat Koxha - anëtar.
- Ky Komision do të jetë organ i përkohshëm i formuar nga Kryetari i Komunës.
- Obligohet Komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në nenin 9, paragrafi 9 i Rregullores së MF. Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionit aktual në fuqi.
- Komisioni gjithashtu obligohet që t'i asgjësoj/tjetërsoj pajisjet e dala jashtë përdorimit të cilat janë evidentuar në Raportin e përgjithshëm të Komisionit të përgjithshëm për vlerësimin e dhe harmonizimin e raporteve të pasurisë jo financiare- inventarizimin e pasurisë jo kapitale.
- Komisioni bashkë me zyrtarin përgjegjës, obligohet që t'i implementoj ndryshimet në sistemin e e-pasurisë.
- Komisioni do të filloj punën pas marrjes së raportit përfundimtar dhe ta përfundoj procesin më së largu më 17.05.2022.

Me këtë Vendim njoftohen:

Anëtarët e Komisionit;

Drejtorja për Buxhet

dhe Financa;

Auditorja e Brendshme;

Arkivi.

Kryetari i Komunës
Z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Nr. 104/02-7231 /22
Kaçanik;

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të nenit 13, 58 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 9 të rregullorës MF – 02/13 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare për Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË CILAT JANË TË PA PËRDORSHME DHE TË PAVLEFSHME QË I PËRKASIN DREJTORISË SË ARSIMIT, DREJTORISË PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE DREJTORISË SË KULTURËS RINIS DHE SPORTIT

1. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve edhe atë:
 - Skender Sopa
 - Besnik Dema
 - Shefket Kuka
2. Anëtarët e komisionit duhet të asgjësojnë sendet të cilat janë të pa përdorshme dhe të pavlefshme dhe që nuk i nënshtrohen ndonjë afati për ruajtje.
3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarte, ashtu siq kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces dhe në fund të përpilojnë raport, një raport t'i dërgohet edhe zyrtarit të pasurisë për ç'regjistrim të aseteve të cilat janë asgjësuar.
4. Antarët e komisionit duhet ta përfundojnë punën e tyre më së largu deri më 22.03.2022

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit,
2. Arkivi

Kaçanik më datë 14.03.2022.



Kryetari i Komunës
Z. Besim Ilazi